



Komercijalna banka  
ad skopje

## **KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PUNË ME AKREDITIVA DOKUMENTARË TË KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE**

Nëpërmjet Kushteve të përgjithshme për punë me akreditivat dokumentare të Komercijalna Banka AD Skopje (në tekstin e mëposhtëm: Banka), rregullohen të drejtat themelore dhe të përgjithshme si dhe parimet e punës me akreditiva dokumentare (në tekstin e mëposhtëm: akreditivat), si instrument i qarkullimit pagesor me jashtë.

### **ZBATIMI I KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME**

Kushtet e përgjithshme zbatohen në marrëdhëniet me idis B ankës, klientit dhe pjesëmarrësve të tjerë në punën me akreditiva, të cilat bazohen në hapjen e akreditivit nëpërmjet Bankës.

### **PUNA ME AKREDITIVE DOKUMENTARE**

Akreditivi dokumentar paraqet detyrim të bankës akredituese në formë të shkruar, i bartur sipas urdhëresës së klientit (në tekstin e mëposhtëm: urdhërdhënës) për sonit të tretë (në tekstin e mëposhtëm: shfrytëzues), të kryejë pagesa për shumën (vlerën) e dokumenteve të prezantuara për pagesë, me kusht që dokumentet të jenë në përputhje me dispozitat dhe kushtet e definuara në tekstin e akreditivit.

Banka i kryen operacionet nga lëmi i punës me akreditiva dokumentare në përputhje me Kushtet e përgjithshme, rregullat ligjore dhe nënligjore vendore (Ligjin për punë valutore, Udhëzimin për mënyrën e realizimit të qarkullimit pagesor me jashtë dhe të tjera), aktet e politikës afariste të Bankës, si dhe praktikën dhe rregullat e vlefshme ndërkombëtare të përkrahura nga të gjithë, të miratuara dhe botuara nga Oda Ndërkombëtare Tregtare e Parisit (UCP for D/C, ISBP, URR, ISP etj.).

Gjatë punës me akreditiva, Banka vepron vetëm me urdhëresë me shkrim, që përmban instruksione të plota, të qarta dhe precize, të cilat janë në përputhje me rregullat vendore dhe ndërkombëtare në fuqi dhe aktet e politikës afariste të Bankës.

Sipas natyrës së tij, akreditivi është transaksion i veçantë dhe i pavarur, juridikisht i përcaktuar nga Marrëveshja për shitblerje (ose tjetër), që mund të paraqesë bazën e akreditivit. Banka nuk është e obliguar me dispozitat e një marrëveshjeje të tillë, as edhe në rastet kur ky obligim është i theksuar në tekstin e akreditivit. Detyrimet e Bankës dalin ekskluzivisht nga akreditivi dhe dispozitat e kushtet e tij.

Gjatë operacioneve me akreditiva, të gjitha palët e përfshira punojnë me dokumente e jo me mallra, shërbime dhe (ose) kryerjen e punëve

të tjera për të cilat mund të jetë i dedikuar dokumenti. .

Banka nuk merr përgjegjësi e as detyrim për formën, plotësinë, saktësinë, autenticitetin, falsifikimin ose veprimin juridik të cilitdo dokumenti prezantuar sipas akreditivit.

Banka nuk merr përgjegjësi e as detyrim për pasojat që mund të ndodhin për shkak të ndërprerjes së punës, si rezultat i fuqisë madhore, apo çfarëdo lloj shkakut tjetër jashtë ndikimit dhe kontrollit të Bankës.

Në rastet kur banka shfrytëzon shërbime nga një bankë tjetër me qëllim zbatimin e instruksioneve të Urdhërdhënësit sipas akreditivit, këtë e bënë në llogari dhe rrezik të Urdhërdhënësit.

Banka nuk merr përgjegjësi e as detyrim për moszbatimin e instruksioneve, që ia ka bartur bankës tjetër, as edhe në rastet kur ka marrë nismë për zgjedhjen e një banke tjetër.

## **KOMPENSIMET**

Banka për llogaritë dhe paguan kompensime dhe shpenzime të sendeve për të gjitha operacionet që i ka kryer sipas akreditivit, edhe atë që nga hapja (evidentimi i kontabilitetit) e akreditivit der në mbylljen e tij (kontabiliteti i arkëtimit). Provizionit i paguar nuk kthehet.

Banka i llogaritë dhe i paguan kompensimet dhe shpenzimet në sende në përputhje me Vendimin në fuqi për Tarifat e kompensimeve për shërbimet, të cilat i kryen Komercijalna Banka AD Skopje, në ditën e realizimit të përlogaritjes.

Nëse sipas akreditivit dalin provizione dhe/ose shpenzime materiale të ndonjë bankë/ave tjetër (tjera), Banka do të angazojë Urdhërdhënësin në lartësinë e shumës së borxhit/kërkesës së marrë nga banka/tjetër (tjera)

## **KONTROLLI I DOKUMENTEVE**

Banka i kontrollon dokumentet e parapara në akreditiv me kujdes, me qëllim të vërtetimit të njëjtat sipas pamjes së jashtme ose nuk janë në përputhje me afatet dhe kushtet e akreditivit.

Banka e kryen kontrollin e dokumenteve në përputhje me praktikën standarde bankare ndërkombëtare, ashtu siç është e përcaktuar në rregullat dhe traditën unike të akreditivit dokumentar dhe standardeve të tjera të përcaktuara, të detyrueshme dhe të pranuar nga të gjithë.

Nëse akreditivi nuk përmban dispozita me të cilët përcaktohet se kush duhet t'i japë dokumentet e kërkuara, në emër të kujt duhet të jenë dhe cilat informacione duhet t'i përmbajnë, Banka do t'i pranojë dokumentet ashtu siç janë prezantuar me kusht të harmonizimit ndërmjet tyre.

## **PAGESAT**

Për pagesat që kryhen me akreditiv, Urdhërdhënësi është i detyruar të sigurojë mbulesë në Bankë. Urdhërdhënësi mund të sigurojë mbulesë nga mjetet e llogarisë së tij në valutë, në denarë ose nga mjetet e kredisë së miratuar, në afatë për të cilat do të merret vesh me Bankën, por më së voni para pagesës sipas akreditivit.

Banka e përpunon pagesën me akreditiv më së voni deri ditën e ardhshme të punës nga dita kur kundërvlera e dokumenteve të akreditivit është miratuar në llogarinë e Bankës.

## **MBYLLJA (LIKUIDIMI) I AKREDITIVIT**

Banka e mbyll akreditivin me arkitimin në evidencën e saj të kontabilitetit pas kalimit të detyrimit të pagesës, përkatësisht pas kryerjes së pagesës pas kalimit të afatit të vlefshmërisë ose më pajtim të ndërsjellë të të gjitha palëve të përfshira.